



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 211/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”, me nr. REF-89394-03-09-2021, me fond limit 109,926,522 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.04.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK
Adresa: Rr. “Asim Vokshi”, pallati “Albuilding”, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Bashkia Elbasan
Adresa: Rr. “Qemal Stafa”, Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.03.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit*”, me nr. REF-89394-03-09-2021, me fond limit 109,926,522 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.04.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.

II.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 17.03.2021 është protokolluar me nr. 1356 prot., datë 17.03.2021 pranë autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK, ndërkohë që referuar formularit të aplikimit AL012006-592421-EL, ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në datën 16.03.2021. Me anë të kësaj ankese, ankimuesi kërkon modifikimin e dokumenteve të tenderit, me argumentin si më poshtë vijon:

“[...]1. Në DST nga ana e AK është kërkuar: 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 90 (nëntëdhjetë) punëtorë te siguruar per periudhen Gusht 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me :

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Nga punonjësit e mësipërm, (duke marrë parasysh numrin e mjeteve) duhet që të jenë minimalisht 11 shoferë, si dhe minimalisht 70 punonjës të pastrimit të rrugëve të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021 në përputhje me VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar”.

Në analizë të dispozitave ligjore, sqarojmë se, Autoriteti Kontraktor gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangi çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, e cila përbën diskriminim ndaj një ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese (award criteria), për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht: “ 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese ”

Është detyrim i autoritetit kontraktor të sigurojë që kërkesat/specifikimet teknike të jenë të shkruara në një mënyrë të tillë që të hapin prokurimin publik ndaj konkurrencës, të lejojnë akses të barabartë për ofertuesit si dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara në hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës.

Vlerësojmë se kriteri i veçantë i kualifikimit që ka të bëjë që 70 punonjësit e pastrimit duhet të jenë të siguruar në përputhje me V.K.M. Nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të rishikuar” vlerësojmë se është një kërkesë e ekzagjeruar dhe diskriminuese pasi punëtorët e pastrimit nuk kanë ndonjë kualifikimin të veçantë dhe shërbimi që ata kryejnë nuk është as profesion e si rrjedhojë kjo kërkesë vjen në kundërshtim me ligjin dhe nuk ka asnjë fuqi provuese për kapacitetin e ofertuesve të mundshëm ekonomik.

Si rrjedhojë kërkohet nga autoriteti kontraktor korigjimin e këtij kriteri.

2. Nga AK në DST është kërkuar:

Për transportimin e mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet mbajtës deri në 8 ton, koeficient kompaktimi 1:4 — 1:6 dhe me kapacitet mbajtës 85% shkak të densitetit të ulët dhe krijojnë volum gjithsej 4 copë.

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën

dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 neni 28, “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Së pari, vlen të sqarohet nga autoriteti kontraktor se si provohet dhe çfarë dokumentacioni provues ka përmbushja e kriterit “me kapacitet mbajtës 85%” dhe si ku bazohet një përcaktim i tillë pasi në vlerësimin e OE ankimes është tërësisht i pabazuar.

3. Nga AK në DST është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e mjeteve kontejnerë, për 700 kontejnerë të mbetjeve urbane me volum 1.1 m³, metalik, të zinkuar. Për të vërtetuar disponimin e kontejnerëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qiramarrësit (në rastin kur merret me qira). Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të kontejnerëve.

Në rast se operatori ekonomik disponon kontejnerët në një formë tjetër të ndryshme nga mënyrat parashikuara më lart si dhe të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar disponimin e tyre.

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 neni 28, “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për

mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të sukseshëm të kontratës. E rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të zotërojnë të gjitha kapacitete e nevojshme teknike në rastin konkret llojin dhe numrin e kazanëve për ekzekutimin e kontratës. Çdo kriter tjetër që tejkalon këtë qëllim është i ekzagjeruar dhe cenon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Vlerësojmë se autoriteti kontraktor abuzivisht ka vendosur numrin 700 kontejnerë pasi nga verifikimi i kryer prej nesh në terren si dhe analizës së preventivit nuk rezultoi që për realizimin me sukses të kontratës të nevojitet një numër i tillë. Sa më sipër kërkojmë rishikimin e këtij kriteri. [...]”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK, me anë të shkresës nr.1356/1prot., datë 18.03.2021, duke mos e pranuar atë.

II.4. Në datën 29.03.2021, operatori ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt, si dhe duke ngritur të njëjtat pretendime me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]1. Në DST nga ana e AK është kërkuar: 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 90 (nëntëdhjetë) punëtorë të siguruar për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me :

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Nga punonjësit e mësipërm, (duke marrë parasysh numrin e mjeteve) duhet që të jenë minimalisht 11 shoferë, si dhe minimalisht 70 punonjës të pastrimit të rrugëve të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021 në përputhje me VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar”.

Në analizë të dispozitave ligjore, sqarojmë se, Autoriteti Kontraktor gjatë përcaktimit të kritereve të veçanta duhet të shmangi çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, e cila përbën diskriminim ndaj një ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese (award criteria), për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të

prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht: “ 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”

Është detyrim i autoritetit kontraktor të sigurojë që kërkesat/specifikimet teknike të jenë të shkruara në një mënyrë të tillë që të hapin prokurimin publik ndaj konkurrencës, të lejojnë akses të barabartë për ofertuesit si dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara në hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës.

Vlerësojmë se kriteri i veçantë i kualifikimit që ka të bëjë që 70 punonjësit e pastrimit duhet të jenë të siguruar në përputhje me V.K.M. Nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të rishikuar” vlerësojmë se është një kërkesë e ekzagjeruar dhe diskriminuese pasi punëtorët e pastrimit nuk kanë ndonjë kualifikimin të veçantë dhe shërbimi që ata kryejnë nuk është as profesion e si rrjedhojë kjo kërkesë vjen në kundërshtim me ligjin dhe nuk ka asnjë fuqi provuese për kapacitetin e ofertuesve të mundshëm ekonomik.

Si rrjedhojë kërkojmë nga autoriteti kontraktor korrigjimin e këtij kriteri.

2. Nga AK në DST është kërkuar:

Për transportimin e mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet mbajtës deri në 8 ton, koeficient kompaktimi 1:4 — 1:6 dhe me kapacitet mbajtës 85% shkak të densitetit të ulët dhe krijojnë volum gjithsej 4 copë.

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 neni 28, “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Së pari, vlen të sqarohet nga autoriteti kontraktor se si provohet dhe çfarë dokumentacioni provues ka përmbushja e kriterit “me kapacitet mbajtës 85%” dhe si ku bazohet një përcaktim i tillë pasi në vlerësimin e OE ankimes është tërësisht i pabazuar.

Pra kërkojmë që autoriteti kontraktor të sqarojë se me anë të cilit dokument provohet një kërkim i tillë për të mos patur vlerësime subjektive nga ana e autoritetit kontraktor.

3.Nga AK në DST është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e mjeteve kontejnerë, për 700 kontejnerë të mbetjeve urbane me volum 1.1 m³, metalik, të zinkuar. Për të vërtetuar disponimin e kontejnerëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qiramarrësit (në rastin kur merret me qira). Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbaje objektin dhe afatin e marrjes me qira të kontejnerëve.

Në rast se operatori ekonomik disponon kontejnerët në një formë tjetër të ndryshme nga mënyrat parashikuara më lart si dhe të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar disponimin e tyre.

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 neni 28, “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:a)licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose c)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose ç)dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të suksesshëm të kontratës. E rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të zotërojnë të gjitha kapacitete e nevojshme teknike në rastin konkret llojin dhe numrin e kazanëve për ekzekutimin e kontratës. Çdo kriter tjetër që tejkalon këtë qëllim është i ekzagjeruar dhe cenon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Vlerësojmë se autoriteti kontraktor abuzivisht ka vendosur numrin 700 kontejnerë pasi nga verifikimi i kryer prej nesh në terren si dhe analizës së preventivit nuk rezulton që për realizimin me sukses të kontratës të nevojitet një numër i tillë.

VENDIM Nr. 319, datë 31.5.2018 PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR KOSTOT E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

Bazuar në Vendim Nr. 319 datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, shtojca 1. pika 1.2 Përlllogaritja e nevojës për investime kapitale (blloku2) thuhet:

- Kapaciteti i kazanëve (tonë) dhe çmimi (lekë). Një kazan tipik ka një vëllim 1.1 m³, i cili ka një kapacitet prej maksimali mbajtës prej rreth 0,10 tonësh mbetjesh mikse, në qoftë se ne konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 tonësh/m³ për mbetjet. Njësia mund të përdorë dhe tipa të tjerë kazanësh me vëllim më të vogël ose më të madh. Kapaciteti i një kazani është në varësi të madhësisë së tij (vëllimi, m³) dhe dendësisë specifike të mbetjeve në kazan. Numri i kazanëve të nevojshëm llogaritet duke marrë në konsideratë një përdorim të kufizuar të mbetjeve, kryesisht shtëpiake. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh “të mëdha” duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Tabela 2

NDËRTIMI I NJË TABELE LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK TË SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 2]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Tipi i kamionit	Tonë	Numër fiks	Zakonisht këtu do të shfaqen tipi 5t ose 10t, por mund të jenë dhe më të vegjël ose më të mëdhenj.
B	Kapaciteti mbushës i kamionit	Tonë	Numër fiks	Përlllogaritet nga formula 85% e kapacitetit mbajtës (85% * A). Kjo për shkak se mbetjet kanë densitet të ulët dhe krijojnë volum, e cila mbush kamionin pa mbërritur peshën.
C	Turnet	Numër	Variabël	Përlllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar (T1C1-K) dhe kapacitetin e kamionit, për të përcaktuar 1 ose dy turne ditore.
D	Kamionë (sasia)	Numër	Variabël	Përlllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar dhe numrin e turneve. Për NJVV-të e mëdha me mbi 50.000 banorë rekomandohet të shtohet dhe një kamion rezervë në rast avarie.
E	Kapaciteti i kazanëve	Tonë	Variabël	Tipi i kazanëve më i përdorur është 1,1 m ³ , i cili mund të mbajë deri në 0,10 ton mbetje. Por, kjo shifër është subjekt rishikimi, duke marrë parasysh se densiteti i mbetjeve është përcaktues për masën.
F	Kazanë (total)	Numër	Variabël	Përlllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve që gjenerohet dhe kapacitetin mbajtës të kazanëve.
G	Kostoja e kamionëve (të gjithë kamionët)	Lekë	Variabël	Përlllogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kamioni (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kamion i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kamionëve
H	Kostoja e kazanëve (të gjithë kazanët)	Lekë	Variabël	Përlllogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kazani (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kazan i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kazanëve
I	Totali i investimeve	Lekë	Variabël	Përlllogaritur nga formula (G + H)

Në dst për objektin “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit” është përcaktuar se sasia e mbetjeve të gjeneruara në ditë është 57 ton dhe kazanët janë të një volumi 1.1 m³ Bazuar në Vendim Nr. 319 datë 31.5.2018, shtojca 1, pika 1.2 Përlllogaritja e nevojës për investime kapitale (blloku2) të sipërcituar numri i kazanëve do të ishte:

Sasia e mbetjeve të gjeneruara në ditë: 57 ton

Kapaciteti i kazanëve 1.1 m³ (0.11 ton/m³)

Nurmi i kazanëve të nevojshëm

$$= \frac{\text{Sasia e mbetjese të gjeneruara në ditë (m3)}}{\text{Kapaciteti i një kazani (ton/m3)}} = \frac{57 \text{ ton}}{0.11 \text{ ton/m3}} \approx 519 \text{ copë [...]”}$$

II.5. Në datën 07.04.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Me anë të shkresës nr. 488/3 prot., datë 20.04.2021, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga autoriteti kontraktor informacion shtesë për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Në datën 07.05.2021, me anë të shkresës nr. 1916/1 prot., datë 05.05.2021, autoriteti kontraktor, ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Vlen të sqarojmë se nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit gjykoj se ankimuesi, prima facie ka respektuar kushtet formale dhe vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur nga ana e autoritetit kontraktor, për verifikimin e fakteve dhe rrethanave përkatëse, të vlefshme për të vlerësuar në lidhje me respektimin e kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pa i hyrë në thelb shqyrtimit të pretendimeve të tij, për faktin se respektimi i kushteve formale, dhe konkretisht në lidhje me afatet e ankimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk ishin shumë të qarta vetëm nga dokumentacioni i paraqitur prej tij në depozitimin e ankesës.

Në lidhje me këto afate, pas shqyrtimit, verifikimit e ballafaqimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, me atë të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton si më poshtë:

III.1.1. Në datën 10.03.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”, me nr. REF-89394-03-09-2021, me fond limit 109,926,522 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.04.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 17.03.2021 është protokolluar me nr. 1356 prot., datë 17.03.2021 pranë autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction”

SHPK, ndërkohë që referuar formularit të aplikimit AL012006-592421-EL, ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në datën 16.03.2021.

III.1.3. Me anë të shkresës nr. 488/3 prot., datë 20.04.2021, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga autoriteti kontraktor informacion shtesë për procedurën e prokurimit objekt ankimi, lidhur me mospërputhjen ndërmjet datës së protokollimit të ankesës dhe datës së dorëzimit të ankesës sipas formularit të aplikimit AL012006-592421-EL.

III.1.4. Në datën 07.05.2021, me anë të shkresës nr. 1916/1 prot., datë 05.05.2021, autoriteti kontraktor, ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e Komisionit të Prokurimit Publik, duke sqaruar si më poshtë vijon:

“[...]Për sa kërkoni në tuajën nr. 488/3 prot., datë 20.04.2021, protokolluar me tonën nr. 1916 prot., datë 22.04.2021, ju bëjmë me dije se ankesa e subjektit “Alko Impex Construction” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - Marrëveshje kuadër”, me objekt : “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”, me nr. REF-89394-03-09-2021, me fond limit 109,926,522 (njëqind e nëntë milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan, është protokolluar në zyrën e protokoll-arshivës, me nr. 1356 prot., datë 17.03.2021.

Për sa i përket formularit të aplikimit me nr. aplikimi AL012006-592421-EL, datë 16/03/2021, ju bëjmë me dije se formulari i plotësuar nga sporteli i zyrës me një ndalesë (One Stop Shop), plotësohet vetëm për kërkesa dhe ankesa të qytetarëve ose dhe të bizneseve, por kur objekti i tyre ka të bëjë me marrjen e një shërbimi të drejtpërdrejtë nga Bashkia Elbasan, siç mund të jenë vërtetimet e ndryshme apo ankesat për ndërhyrjen e strukturave të shërbimeve.

Në çdo rast këto formularë dorëzohen në protokoll-arkiv ditën e nesërme të punës dhe në këtë moment marrin një numër protokoll sipas rregullimit ligjor që të protokoll arkivës dhe konsiderohet zyrtarisht i dorëzuar [...]”

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pikat 1, dhe 1.1, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”*

III.1.6. Nga interpretimi literal i dispozitës të sipërcituar, Komisioni gjykon se për dokumentet e tenderit operatorët ekonomikë mund të paraqesin ankesë pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Pra, për plotësimin e kushteve formale të ankimit, një prej të cilave është edhe respektimi i afateve të përcaktuara në nenin 63, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin

publik”, i ndryshuar, lidhur me kundërshtimin e dokumenteve të tenderit, operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqesin ankesën brenda 7 ditëve nga data e publikimit, pranë ambienteve të autoritetit kontraktor. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor brenda afateve të ankimit, pasi referuar bazës ligjore të sipër cituar, nuk është e rëndësishme se në cilën prej strukturave pritëse të ankesave të autoritetit kontraktor është dorëzuar ankesa, e rëndësishme është që ankesa është marrë në dorëzim nga autoriteti kontraktor brenda afateve të ankimit. Në këto kushte, për sa kohë që operatori ekonomik, me anë të dokumentacionit të paraqitur, provon se ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor në datën 16.03.2021, Komisioni gjykon se ankesa plotëson kushtet formale, ndaj dhe do të vijohet me shqyrtimin në themel të saj.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Vlerësojmë se kriteri i veçantë i kualifikimit që ka të bëjë që 70 punonjësit e pastrimit duhet të jenë të siguruar në përputhje me V.K.M. Nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të rishikuar” vlerësojmë se është një kërkesë e ekzagjeruar dhe diskriminuese pasi punëtorët e pastrimit nuk kanë ndonjë kualifikimin të veçantë dhe shërbimi që ata kryejnë nuk është as profesion e si rrjedhojë kjo kërkesë vjen në kundërshtim me ligjin dhe nuk ka asnjë fuqi provuese për kapacitetin e ofertuesve të mundshëm ekonomik. Si rrjedhojë kërkojmë nga autoriteti kontraktor korrigjimin e këtij kriteri [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.8, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 90 (nëntëdhjetë) punëtorë të siguruar për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021 të vërtetuar me :

a)Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse,në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

b)Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Nga punonjësit e mësipërm, (duke marrë parasysh numrin e mjeteve), duhet që të jenë minimalisht 11 shoferë , si dhe minimalisht 70 punonjës të pastrimit të rrugëve, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, në përputhje me V.K.M. Nr 514, datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar””

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]

III.2.3. Në nenin 28, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

III.2.4. Në nenin 28, pika 5, gërmat “b” e “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:[...] b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose[...]”.

III.2.5. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Lidhur me pretendimin e ankimesit mbi përcaktimin e autoritetit kontraktor se 70 punonjësit e pastrimit të rrugëve duhet të jenë të siguar në përputhje me V.K.M. Nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të rishikuar”, Komisioni konstaton se për punonjësit e pastrimit të rrugëve akti nënligjor i mësipërm, për miratimin e listës kombëtare të profesioneve, nuk përcakton asnjë kod, si dhe nuk i parashikon punonjësit e pastrimit të rrugëve si profesion. Komisioni gjykon se kriteri i mësipërm shkakton konfuzion dhe kufizime të panevojshme, për sa kohë Lista Kombëtare e Profesioneve nuk e parashikon pozicionin e punës për punonjësit e pastrimit të rrugëve. Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të krijojë bindjen se operatorët ekonomik disponojnë stafin e nevojshëm për zbatimin me sukses të kontratës, por gjithmonë duke përcaktuar kriterë në përputhje me objektin e kontratës, në përpjesëtim me volumin e saj, si dhe jo kufizuese apo diskriminuese. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke e hartuar atë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe atë sektorial në fuqi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK “Për transportimin e mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet mbajtës deri në 8 ton, koeficient kompaktimi 1:4 — 1:6 dhe me kapacitet mbajtës 85% shkak të densitetit të ulët dhe krijojnë volum gjithsej 4 copë. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në

përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 neni 28, “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Së pari, vlen të sqarohet nga autoriteti kontraktor se si provohet dhe çfarë dokumentacioni provues ka përmbushja e kriterit “me kapacitet mbajtës 85%” dhe si ku bazohet një përcaktim i tillë pasi në vlerësimin e OE ankimes është tërësisht i pabazuar. Pra kërkojmë që autoriteti kontraktor të sqarojë se me anë të cilit dokument provohet një kërkim i tillë për të mos patur vlerësime subjektive nga ana e autoritetit kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi kriteret e kualifikimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e kriterin dhe ka parashtruar pyetje. Gjithashtu, KPP-ja konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”, nuk ka dhënë asnjë sqarim për operatorin ekonomik ankimes, lidhur me kriterin e veçantë të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të bëjë sqarimin përkatës dhe të publikojë këtë sqarim, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të suksesshëm të kontratës. E rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të zotërojnë të gjitha kapacitete e nevojshme teknike në rastin konkret llojin dhe numrin e kazanëve për ekzekutimin e kontratës. Çdo kriter tjetër që tejkalon këtë qëllim është i ekzagjeruar dhe cenon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Vlerësojmë se autoriteti kontraktor abuzivisht ka vendosur numrin 700 kontejnerë pasi nga verifikimi i kryer prej nesh në terren si dhe analizës së preventivit nuk rezulton që për realizimin me sukses të kontratës të nevojitet një numër i tillë[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr.8, pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e mjeteve kontejnerë, për 700 kontejnerë të mbetjeve urbane me volum 1.1 m³, metalik, të zinguar. Për të vërtetuar disponimin e kontejnerëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasisë e mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qiramarrësit (në rastin kur merret me qira). Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të kontejnerëve. Në rast se operatori ekonomik disponon kontejnerët në një formë tjetër të ndryshme nga mënyrat e parashikuara më lart si dhe të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar disponimin e tyre”

III.4.2. Në shtojcën nr.9, “Specifikime teknike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“Transporti e largimi i mbetjeve urbane konsiston në:

-Ky shërbim do të kryhet gjatë natës nga ora 2400 – 0800. Sasia e mbetjeve urbane që do të transportohet çdo ditë është 57 ton.

Nga të cilat :

-Mesatarisht 57 ton në ditë do të transportohen nga vend – grumbullimet të përcaktuar sipas studimit të bërë paraprakisht në të cilat janë vendosur kontejnerët; me mjete teknologjike me kapacitet deri në 8 ton, koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 dhe me kapacitet mbajtës 85% për shkak të densitetit të ulët dhe krijojnë volum.

-Dhe 8 ton në ditë me mjete të thjeshta dora - dorës ,direkt nga familjarët.

-Vlerësimi i sasisë së mbetjeve urbane të cilat do të transportohen si më lart; do të bëhet sipas sasisë të peshuara në Landfill të shoqëruara me Fletë – Peshimi(flete pranimeve të mbetjeve urbane) për çdo mjet dhe për çdo ditë të konfirmuara nga Landfilli dhe vërtetimi përmbledhës mujor për çdo mjet, për çdo ditë e për çdo rrugë.

-Përllogaritjet e shpenzimeve të përgjithshme në hartimin e Situacionit mujor, do të kryhen vetëm në bazë të Fletë– Peshimeve (flete pranimeve të mbetjeve urbane) për çdo mjet dhe për çdo ditë të konfirmuara nga Landfilli dhe vërtetimi përmbledhës mujor.

-Autoriteti kontraktor për kohëzgjatjen e këtij Tenderi ka parashikuar dhe vlerësuar që vendosja e 700 cope kontejnerëve të mbetjeve urbane me volum 1.1m³ të zinkuar, në Zonën e kontratës të behet nga Operatori ekonomik (sipërmarrësi).

-Në 5 rrugë të Qytetit Rruga "Rinia, Thoma Klefi, Qemal Stafa, 28 Nëntori, Aqif Pasha" do të pilotohet ndarja në burim për plastikë, qelq dhe letër do pilotohet në 5 Supermarkete ku kontejnerët do të kenë mbishkrimin përkatës sipas ndarjeve.

-Vendosja e tyre do të bëhet në përputhje me Plan-vendosjen dhe hartën në të cilat janë përcaktuara të gjitha koordinatat për çdo Vend- grumbullim të mbetjeve urbane të përcaktuara nga Autoriteti kontraktor, të cilat janë pasqyruara në Hartat përkatëse, nga ku së bashku me listën janë pjesë e dokumenteve të Tenderit.

-Operatori ekonomik në zbatim të detyrime kontraktore, për çdo ditë duhet të zbrazë 700 copë kontejnerë respektivisht nga 175 copë për çdo mjet transporti teknologjik dhe për çdo ditë me mjete të thjeshta vetëshkarkuese do të largojë mbetjet urbane në të gjitha familjet të planifikuara sipas zonave(enklava)të banuara.

-Mjetet teknologjike, gjatë transportimit dhe largimit të mbetjeve urbane janë të detyruar që të pastrojnë nga mbetjet të hedhura për rreth kontejnerëve, fshirjen me krah të sipërfaqes me rreze 3 ml të V.G.M. dhe rivendosjen e kontejnerëve në vendin e caktuar në mënyrë të rregullt dhe estetike, dhe në përfundim të këtij procesi përfshihet dhe dezinfektimi i kontejnerëve dhe i zonës për rreth me gëlqere me 5% përmbajtje klori.

Plani i vendosjes së kontejnerëve dhe grafikëve të punimeve

-Autoriteti Kontraktor paraprakisht ka bërë studimin e zonës së kontratës dhe ka përcaktuar vend - grumbullimet të mbetjeve urbane dhe numrin e kontejnerëve për çdo vend - grumbullim në të gjithë zonën e kontratës, duke përgatitur dhe Hartat përkatëse për këtë qëllim.

-Operatori është i detyruar të zbatojë vetëm planifikimin dhe përcaktimin nga Autoriteti Kontraktor Planin, dhe ndalohet kategorikisht të bëjë ndryshimin e tyre përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

-Ky plan mund të ndryshojë gjatë zbatimit të kontratës nga Operatori i ekonomik ose Autoriteti Kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirëorganizimit të tij ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë, por gjithmonë me miratim të Autoritetit Kontraktor.

-Grafiku i shërbimit të pastrimit të qytetit, përgatitet nga Operatori ekonomik dhe miratohet për çdo fillim kontrate nga Autoriteti Kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda kësaj periudhe.

-Në grafikun e punimeve për çdo proces shërbimi, duhet të përcaktohet:

Orari i fillimit të shërbimit.

Për çdo mjet transporti duhet të përcaktohet: lloji, targa dhe itinerari i lëvizjeve si për mjetet teknologjike dhe mjeteve të thjeshta vete shkarkuese që janë të destinuara të kryejnë shërbimin.

Numrin e operatorëve(punëtorëve) që janë pjesë e kryerjes së këtij procesi shërbimi.

Operatori ekonomik nuk mund të punojë e të paguhet pa u miratuar paraprakisht detyrimet kontraktore të mësipërme.

-Menaxhimi dhe planifikimi nga ana e Operatorit ekonomik për kryerjen e këtij shërbimi duhet të garantojë që; transporti dhe largimi i mbetjeve urbane do të kryhen sipas kërkesave teknike dhe brenda orës 0800

-Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe pas përfundimit të shërbimit VGM, të shohë respektimin e kërkesave, rregullave dhe cilësinë e kërkuar nga kjo kontratë për të vendosur penaltite ose ndalesa në rastet e mos përmbushjes së tyre”

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me makineritë, pajisjet dhe materialet që shërbejnë për zbatimin me sukses të shërbimit objekt prokurimi, por në çdo rast këto kriteret duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, pasi vendosja e kriterëve joproporcionale dhe të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues konstaton se referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor në cilësinë e insitucionit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në respekt të nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar nuk ka parashtruar argumente teknike, për të justifikuar kërkesën për disponimin e 700 kontejnerëve. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka bërë publike as hartën e shpërndarjes së këtyre kontejnerëve, të cilën e ka përmendur në specifikimet teknike, me qëllim përlllogaritjen në mënyrë transparente të kontejnerëve të nevojshëm për kryerjen me sukses të shërbimit të kërkuar. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të riformulojë kriterin e mësipërm duke ripërlllogaritur numrin e kontejnerëve të nevojshëm, në përputhje me volumin e kontratës, si dhe duke bazuar teknikisht në VKM. Nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane”, pasi dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”, me nr. REF-89394-03-09-2021, me fond limit 109,926,522 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.04.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë këto ndryshime në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 488 Protokoli, Datë 29.03.2021;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri